

SHEJH SALIH EL FEUZAN

Roli i gruas
NË EDUKIMIN E
FAMILJES



Titulli në origjinal:

A Woman's Guide to Raising a Family

Titulli në shqip:

Roli i gruas në edukimin e familjes¹

Autori:

Shejh Salih el Feuzan, Allahu e ruajttë!

Përktheu nga gjuha angleze:

Ummu Aishe Retkoceri

Redaktor fetar:

Hoxhë Lulzim Perçuku

Redaktoi:

Rexhina Shuli

Kopertina dhe faqesja:

Denisa Zeqiri

Botim privat

Dhjetor, 2024

¹ Ky libërth është përkthyer dhe ligjruar nga përkthyesja në tri ligjërata, në një kurs veror në kuadër të grupit “Derse javore” për gratë. Më pas, me kontributin e anëtareve të grupit, u botua. (sh.p)

HYRJE



I gjithë falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Te Allahu kërkojmë ndihmë të na ruajë nga shërri i vetes sonë dhe shërri i punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush e devijon, e atë që e devijon Allahu nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një e të Vetëm, dhe se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij. Salati dhe selami qofshin mbi të, familjen dhe shokët e tij!



Pastaj: Ligjërata jonë do të jetë për gruan muslimane. Besoj që çdo ligjëratë sa i përket kësaj teme është e rëndësishme, sidomos në këtë kohë. Kjo ndodh sepse gruaja muslimane në kohën tonë i nënshtrohet sulmeve të pamëshirshme nga armiqtë e kësaj feje, sa herë që ngrihet tema e ashtuquajtur “çështja e gruas”. Me këtë ata synojnë ta zhvendosin gruan nga vendi të cilin Allahu e ka paraparë për të.

Ne (muslimanët) nuk dimë që gruas duhet t’i interesojë ndonjë çështje tjetër përveç çështjes së umetit të saj. Pra, çështja për të cilën duhet të interesohet gruaja muslimane është mosdija e umetit në përgjithësi dhe e grave në veçanti për fenë e tyre, si dhe kapja e dobët e tyre pas kësaj feje.

Prandaj, këtë do të përpiqemi ta sqarojmë, në këtë ligjëratë me titull: **“Roli i gruas në edukimin/rritjen e familjes.”**²

Sa i përket kësaj teme, janë disa çështje për t’u diskutuar:

E para: Koncepti i “edukimit”. Me edukim kemi për qëllim kuptimin e gjerë të ndërtimit të familjes dhe përkushtimin e kujdesin e nevojshëm për të. Këtë e themi që të mos mendojnë disa se edukimi (i familjes) është thjesht formimi dhe përsosja e karakterit, edhe pse kjo përfshihet te edukimi, por edukimi i familjes është shumë më i gjerë se kjo.

E dyta: Nga titulli mund të kuptohet që gruaja ka vetëm njëfarë roli në edukimin e familjes dhe se kjo është një detyrë dytësore për të. Por, e vërteta është se detyra e gruas në edukimin/rritjen e familjes është përgjegjësia e saj e parë dhe se çdo gjë tjetër përveç kësaj bën përjashtim. Sikur titulli i ligjëratës të ishte: “Roli i gruas është ta edukojë/rrisë familjen”, atëherë kjo do të ishte më mirë.

²Origjina e kësaj teme ka qenë një ligjëratë e titulluar: “Roli i gruas në edukimin e familjes”, e cila është mbajtur të martën, më datë 6 Dhul Kadeh 1411. Kjo ka qenë pjesë e një seminari të dijes, të quajtur “Fikhu i gruas”, i cili është mbajtur nga Qendra e Davetit dhe e Udhëzimit në Rijad, në xhaminë el-Dhijab, në lagjen en-Nesim.

VENDI I GRUAS

Kjo çështje duhet të sqarohet dhe të shpjegohet. Vendi natyral për gruan është shtëpia dhe ky është vendi i saj i punës. Kjo është origjina, e cila mbështetet nga argumentet fetare. Madje kjo është në pajtueshmëri me fitren (natyrën fillestare) në të cilën është krijuar gruaja. Sa i përket argumenteve fetare (nga Kurani dhe Suneti) ka shumë tekste dhe ndodhi që dëshmojnë për këtë. Prej tyre:

E para: Allahu i Lartësuar ka thënë, duke iu referuar nënave të besimtarëve: **“Dhe qëndroni në shtëpitë tuaja.”** (*El-Abzab: 33*) Ky ajet përmban një shenjë të fshehur për të treguar se shtëpia është themeli i jetës së tyre (grave) dhe vendi ku duhet të qëndrojnë. Çdo vend tjetër bën një përjashtim të rastit, ku ato nuk duhet të vendosen dhe të stabilizohen, përkundrazi aty qëndrojnë vetëm deri sa t’i përmbushin nevojat e tyre (sipas masës).

E dyta: I Lartësuari ka thënë: **“Mos i dëboni ato prej shtëpive të (burrave të) tyre, por edhe ato të mos largohen...”** (*Et-Talak: 1*) Edhe pse ky ajet flet për gratë që janë në periudhën e tyre të idetit (pritjes pas divorcit), dijetarët kanë thënë që ky vendim nuk është i veçantë veç për këtë. Por, shtrihet më shumë se aq. Fakti që përmend “shtëpitë e tyre”, përderisa në shumicën e rasteve shtëpia i takon burrit, tregon që përshkrimi këtu është për vendin e banimit dhe jo atë të pronësisë, sikur origjina të gruaja është që ajo ta ketë një shtëpi ku banon (qëndron).

E treta: Në tregimet e Pejgamberëve ka mësimë dhe këshilla. Për shembull, tek tregimi i Musait dhe dy vashave, Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur arriti tek pusi i Medjenit, ndeshi rreth tij shumë njerëz që u jepnin ujë kafshëve. Përveç atyre, ai vuri re dy vasha që po mbanin kafshët e veta. Ai tha: “Si e keni hallin ju?” Ato thanë: “Ne nuk u japim ujë, pa u larguar barinjtë. Babai ynë është shumë plak.”** (El-Kasas: 23)

Deri te pjesa: **“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja, - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim.”** Plaku tha: **“Unë dua të të jap për grua njëren prej këtyre dy bijave të mia, me kusht që të më shërbesh mua tetë vjet; por, nëse dëshiron, mund të qëndrosh dhjetë vjet. Unë nuk dëshiroj të t’i rëndoje gjërat. Ti do të shohësh, në dashtë Allahu, se jam një njeri i mirë.”** (El-Kasas: 26-27)

Të meditojmë në këto mësimë brenda ajetit. Ky është Musai, i cili i gjeti barinjtë te një burim uji dhe në mesin e tyre ishin dy vasha, të cilat po i mbanin bagëtinë e tyre që të mos përziheshin me bagëtitë e njerëzve. Ai i pyeti ato: “Si e keni hallin ju?” Që do të thotë: pse nuk po u jepni ujë bagëtive tuaja bashkë me njerëzit? Vjen përgjigjja: “Ne nuk u japim ujë (bagëtive tona) derisa barinjtë të largohen.” Vërtet, ato kishin fetari dhe devotshmëri që i ndaloi nga përzierja me burra të huaj. Pastaj, sikur parashtrohet një pyetje tjetër: “Çfarë ju ka nxjerrë juve nga shtëpia?” Prandaj, ato u përgjigjën menjëherë: “Babai ynë është shumë plak.” Pra, këtë gjë (daljen nga shtëpia) e kërkonte nevoja e domosdoshme. Por, dhe pse qenë detyruar

të dalin jashtë shtëpisë, ato treguan sjellje të mirë dhe edukatë të lartë, duke mos u përzier me burra të huaj.

Po ashtu, në këtë (ngjarje) përfitohet një mësim tjetër: kur njëra nga ato dy vasha mendoi që ka ardhur koha që çështjet të kthehen në gjendjen e tyre normale. Allahu i Lartësuar tregon se ajo tha: **“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja, - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim.”** Kështu, Shuajbi u bind nga ky sugjerim dhe ia prezantoi atë Musait. **“Plaku tha: “Unë dua të të jap për grua njëren prej këtyre dy bijave të mia, me kusht që të më shërbesh mua tetë vjet...”** (*El-Kasas: 27*)

Musai e pranoi këtë propozim dhe çështjet u kthyen në normalitet. Musai punoi si bari, ndërkohë gruaja e tij u kthye në punët brenda shtëpisë. Kjo është çfarë na rrëfen Kurani dhe në këto tregime ka mësim.

E katërta: Namazi në xhami është i ligjësuar për burrat dhe është prej veprave më të mira. Po nëse ky namaz falet në xhaminë e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) dhe bashkë me të? Megjithëkëtë, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) i ka inkurajuar gratë që të falen në shtëpitë e tyre. Transmetohet nga gruaja e Ebu Humejd es-Saidi, e cila erdhi te i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) dhe i tha: *“O i Dërguar i Allahut, unë dua që të falem me ty.”* Ai (sal-lAllahu alejhi ue selem) i tha: *“E di që ti dëshiron të falesh me mua, por namazi yt në dhomën tënde është më i mirë sesa namazi yt në dhomën e ndejës; dhe namazi yt në dhomën e ndejës është më i mirë sesa*

namazi yt në pjesën tjetër të shtëpisë; dhe namazi yt në shtëpinë tënde është më i mirë se namazi yt në xhaminë e lagjes; dhe namazi yt në xhaminë e lagjes është më i mirë sesa namazi yt në xhaminë time.”

Kështu ajo urdhëroi që të ndërtohej një faltore (xhami),³ në pjesën më të izoluar dhe më të errët brenda shtëpisë së saj, dhe u fal aty deri sa e takoi Allahun, të Gjithëfuqishmin, Madhështorin.⁴

Ky hadith tregon qartë se në parim gruaja duhet të qëndrojë në shtëpinë e saj, aq sa i Dërguari (sal-lAllahu alejhi ue selem) e konsideroi namazin e saj në shtëpinë e saj më të mirë sesa namazin e saj në xhaminë e tij, edhe pse ai ua kishte lejuar grave të faleshin në xhami.

E pesta: Këtë konkluzion e mbështet edhe gjendja e gruas në tri gjeneratat e para të virtytshme, të cilat janë shembuj për t'u ndjekur, sepse shohim që dalja e grave nga shtëpia dhe puna e tyre jashtë ka qenë e limituar në disa raste të caktuara, për të cilat ka pasur arsye që e kanë kërkuar një gjë të tillë. Madje, kështu e kuptuan edhe sahabët këtë çështje. Transmetohet se gruaja e Ibn Mes'udit, ka kërkuar nga ai një xhilibab (mbulesë e trupit) dhe ai i ka thënë: “Kam frikë se do ta lësh mbulesën e Allahut me të cilën ai të ka mbuluar.” Ajo tha: “Cila është ajo?” Ai i tha: “Shtëpia jote.”

³ Vend i veçuar për faljen e namazit.

⁴ Hasen: Transmetuar nga Ahmedî (6/341) dhe Ibn Huzejmeh në Sahihun e tij (3/95). Shejh Albani e ka cilësuar Hasen në “Sahih et-Tergib uet-Terhib”.

E gjashta: Ajo që ka ardhur në ligjin hyjnor përputhet me fitren (natyrën në të cilën Allahu e krijoi njeriun). **“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njih çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!”** (*El-Mulk: 14*)

Vërtet, qëndrimi i gruas në shtëpi përputhet me fitren, gjë që është e përshtatshme për detyrat dhe natyrën e saj, si dhe e mbron atë nga shpërqendrimi dhe kontradiktat. Hulumtimet shkencore dhe studimet psikologjike kanë arritur në përfundime të cilat e mbështesin këtë që u tha më lart. Një numër i studiuesve të paanshëm në Perëndim kanë bërë thirrje për shmangien e rrezikut që vjen si rezultat i ngarkesës së grave me punë, të cilat e kundërshtojnë fitren dhe prirjet e saj natyrale. Megjithatë, ndjekësit e epsheve janë të shurdhër ndaj kujt do që fton në këtë, madje i akuzojnë ata se gjoja po bëjnë thirrje që gruaja të kthehet në epokën e prapambetjes dhe skllavërisë. Kjo është çfarë ata pretendojnë. Kjo do të shpjegohet më poshtë gjatë shtjellimit të kësaj teme.

QËNDRIMI NË LIDHJE ME DALJEN E GRUAS NGA SHTËPIA

Duhet të kuptohet se nuk është e ndaluar rreptësisht që gruaja të dalë nga shtëpia. Ka tekste (nga Kurani dhe Suneti) që tregojnë lejueshmërinë që gruaja të dalë dhe të punojë jashtë shtëpisë. Por, kjo situatë nuk është esenca (parimi); por është një përjashtim nga parimi për shkak të nevojës.

Si shembull për këtë mund të përmendet hadithi ku tregohet se i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) i ka lejuar gratë të falen në xhami, edhe pse e ka sqaruar se është më mirë për to që të falen në shtëpitë e tyre.

Shembull tjetër janë hadithet që tregojnë se disa gra kanë marrë pjesë në disa beteja, duke ofruar ujë dhe duke i trajtuar të lënduarit.

Thirrësit për “çlirimin” e gruas, e që në realitet janë prej pasuesve të epsheve të cilët thërrasin për prishjen e saj, përpiqen që të kapen pas këtyre teksteve dhe argumentojnë me to. Madje, edhe disa njerëz të mirë, të cilët u mundën përballë presionit të këtij civilizimi të importuar, po ashtu argumentuan me këto tekste, duke besuar se po e mbrojnë Islamin.

Si përgjigje për këtë, ne themi:

Nuk është e ndaluar rreptësisht që gruaja të dalë nga shtëpia dhe të punojë jashtë. Mund të ketë ndonjë nevojë për këtë (në disa raste), siç ka ndodhur me dy vajzat e Shuajbit kur ato u detyruan të dilnin.

Nganjëherë kjo mund të jetë e domosdoshme për Umetin, siç është rasti kur gruaja duhet t'i mësojë vajzat e komunitetit të saj dhe t'u ofrojë atyre trajtim mjekësor. Argumentet që e pohojnë lejimin e daljes së gruas nga shtëpia duhet të kuptohen në këtë këndvështrim. Mirëpo, siç u tha më lart, këto raste nuk tregojnë se ky është parimi, por janë përjashtim nga parimi. Për këtë, gjejmë se Imam Ibn Haxheri ka thënë: “Ka mundësi që dispozita, e cila e lejon gruan të shoqërojë ushtrinë, është shfuqizuar.”

Ibën Haxheri e shënon këtë në librin e tij “El-Isabeh” në biografinë e Ummu Keshshah El-Kadaijeh. Aty thotë: “Ebu Bekër ibn Ebi Shejbeh, Taberaniu dhe të tjerë transmetojnë se Ummu Keshshah, një grua nga Kada'ah, ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, më jep leje të shkoj me këtë dhe këtë ushtri!” Ai tha: “Jo.” Ajo i tha: “Unë nuk dua të luftoj. Unë vetëm dua t'i trajtoj të lënduarit dhe të sëmurët dhe t'u jap ujë.” Ai (sal-Allahu alejhi ue selem) tha: “*Sikur të mos ishte se do të bëhej sunet (traditë) dhe se do të thubej: “Filan grua ka dalë jashtë (bashkë me ushtrinë)”, atëherë do të ta lejoja. Por, qëndro në shtëpi.”*”⁵

Gjithashtu, këtë hadith e ka transmetuar edhe Ibn Sa'di dhe në fund të tij shton: “*Qëndro (në shtëpi) në mënyrë që njerëzit të mos thonë: “Muhamedi shkon në beteja me gra.”*”

Pas kësaj, Ibën Haxheri thotë: “Është e mundur të ketë pajtim mes këtij transmetimi dhe atij paraprak, i cili përmendet në biografinë e Umm Sinan el-Eslemijeh, duke thënë se ky

⁵Sahih. Hadithi është deklaruar Sahih nga shejh Albani në “Es-Sahihah”, nr. 2740.

(transmetim) e shfuqizojnë të parin, sepse hadithi i parë flet për në betejën që ka ndodhur në Hajber, ndërsa ky i fundit flet përkohën pas çlirimit të Mekës.⁶”⁷

Sidoqoftë, ka dëshmi të vërtetuara, të cilat pohojnë se disa gra kanë dalë dhe kanë marrë pjesë duke i trajtuar të plagosurit dhe duke u dhënë ujë. Megjithatë, këto janë numër i kufizuar i rasteve, të cilat janë vlerësuar me masë, ndaj ato nuk marrin epërsi mbi parimin (e qëndrimit të gruas në shtëpi), duke u parë kështu si përjashtim.

Prandaj, është thelbësore të sqarohet dallimi: A është puna e gruas jashtë shtëpisë parim apo një përjashtim?

Nëse llogaritet si përjashtim për situata të veçanta, atëherë nuk është e vështirë për ne që t'i numërojmë rezultatet negative të parashikuara nga dalja prej shtëpisë, por ky nuk është vendi për ta diskutuar këtë çështje. Megjithatë, nëse dalja e gruas nga shtëpia konsiderohet si parim, siç e shohin disa perëndimorë, të cilët besojnë se gruaja do të mbetet e papunë nëse punon në shtëpi dhe se kjo paralizon gjysmën e shoqërisë, atëherë unë them: nëse ecim në këtë drejtim, do të shfaqen efektet negative të daljes së gruas nga shtëpia dhe do të ndodhin pasojat e këqija të kësaj, siç ka ndodhur në shoqëritë perëndimore. Rezultatet do të jenë - pa marrë parasysh se çfarë masash marrim dhe sa jemi të sigurtë në këtë - të këqijat e përzierjes së lirshme mes gjinive dhe të këqijat e mungesës së nënës në shtëpi. Edhe pse

⁶Domethënë ka ndodhur më vonë.

⁷El-Isaabeh (4/463)

disa përpiqen që ta mbulojnë këtë me slogane mashtruese si “të dalë gruaja jashtë shtëpisë nën dritën e mësimeve të fesë sonë dhe në përputhje me traditat tona”.

Pra, duhet të kuptojmë patjetër që, kur vërtetohet se parimi është që gruaja të punojë brenda shtëpisë së saj, dhe se puna e saj jashtë shtëpisë është përjashtim, gjë që edhe argumentet fetare (të Kuranit dhe Sunetit) e kërkojnë, atëherë nëse jemi muslimanë të vërtetë, duhet të jemi të bindur se nuk e kemi të drejtën që të zgjedhim nëse duhet t'i përmbahemi apo jo këtij parimi.

Allahu thotë në Kuran: **“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyre. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”** (*El-Abzab: 36*)

Edhe pse ky ajet ka zbritur për një çështje të caktuar, kuptimi i tij është i përgjithshëm. Për më tepër, ka ardhur pas ajeteve të cilat i urdhërojnë gratë e Pejgamberit (sal-lAllahu alejhi ue selem) që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.

Allahu e ka sqaruar se braktisja e Ligjit të Tij dhe shmangia nga ai është pa dyshim një arsye e paevitueshme për një jetë të mjeruar, siç është rasti i shumicës së popujve në botë sot.

“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” (*Ta Ha: 124*)

Gjendja e një vendi (dhe populli) që e posedon metodologjinë e vërtetë dhe të drejtë, por e braktis atë, dhe kërkon në mbeturinat e teorive të njerëzve, është e ngjashme me (atë që përshkruhet në) thënien e poetit:

Sikur deveja në shkeretëtirë që nga etja vdes

Megjithëse ujin e bart në shpinën e vet

DOMETHËNIA E FJALËS “FAMILJE” DHE SQARIMI I RËNDËSISË SË SAJ

Çështja e tretë e diskutimit, për sa i përket kësaj teme, është rreth (fjalës) “familje”. Çfarë është familja, e cila është fushë veprimi e gruas? Dhe cila është rëndësia e saj?

Familja është një nga institucionet edukative të përhershme që nuk pushon kurrë. Nuk mund të paramendohet një shoqëri pa familje. Ekzistenca, vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e saj janë ndër objektivat e ligjit hyjnor.

Allahu i Lartësuar thotë: **“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij (Ademit) krijoi bashkëshorten e tij (Havanë), kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra...”** (*En-Nisa: 1*) Ky ajet tregon se origjina e racës njerëzore është një familje. Pastaj, prej dy bashkëshortëve, erdhën shumë familje.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Është Ai që ka krijuar njeriun prej ujit, e ka vënë në lidhje me fis nga gjaku dhe nga martesja. Zoti yt është i Plotfuqishëm.”**

(*El-Furkan: 54*)

Islami inkurajon ndërtimin e familjes, kur përmbushen kushtet e nevojshme. Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: **“O ju të rinj, kush nga ju ka mundësi, le të martohet!”**⁸

Po ashtu ka thënë: **“Martohuni me gratë që janë të dashura**

⁸Transmeton Buhariu në kapitullin e martesës.

dhe që lindin shumë!”⁹

Feja islame e ka sqaruar rolin e familjes dhe ndikimin e saj të madh, sepse ajo e përcakton rrjedhën e jetës dhe fesë së fëmijës. Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Çdo fëmijë lind në natyrshmëri të pastër (Islame), por prindërit janë ata që e bëjnë atë hebre, ose të krishterë, ose mexhusi.”¹⁰*

Ligjet dhe dispozitat e Islamit kanë ardhur për ta organizuar familjen dhe për ta mbrojtur atë nga shpërbërja, siç janë edhe dispozitat e martesës, divorcit, periudhat e pritjes (pas divorcit), të drejtat e babait, nënës dhe shumë të tjera. Të gjitha këto tregojnë për pozitën që Islami i ka dhënë familjes, sepse ajo është vendi ku rriten brezat dhe prej gjendjes së familjes, varet e ardhmja e umetit islam.

Vërtet, gruaja është shtylla kurrizore e familjes, siç është thënë: *“Pas çdo burri të madh është një grua, në shtëpinë e së cilës ai është rritur/edukuar.”*

A nuk e meriton kjo familje kohën e plotë të një gruaje dhe a është një mund i kotë (i humbur) puna e gruas brenda familjes së saj? Detyra e gruas është mëmësia me të gjitha përgjegjësitë e saj, e cila më tepër se thjesht lindja, është edukimi që përgatit një individ të mirë.

Vërtet, puna e gruas brenda shtëpisë, edhe pse disa e shohin si

⁹ Buhariu (nr. 4778), Muslimi (nr. 1400), Tirmidhiu (nr. 1081), En-Nesaiu (nr. 2240), Ebu Daudi (nr. 2046), Ibn Maxheh (nr. 1845), Ahmedi (1/378), Ed-Darimi (nr. 1265).

¹⁰ Buhariu (nr. 1292), Muslimi (nr. 2138) dhe Ebu Daudi (nr. 2714).

të parëndësishme, është madhështore, në të cilën bashkohen shumë specializime dhe ka nevojë për ato gjëra që i duhen një shteti (për të funksionuar). Kërkon dije, largpamësi, saktësi, administrim, ekonomizim, butësi, ndjeshmëri dhe principe të larta.

Kur një grua e sheh me përbuzje punën e saj brenda shtëpisë, është dëshmi e qartë që ajo nuk e ka kuptuar siç duhet, dhe kjo është arsyeja pse ajo nuk e plotëson atë. Po ashtu, edhe ata që besojnë se gruaja është boshe (e papunë) në shtëpinë e saj, ose nuk e kuptojnë këtë detyrë, ose e kuptojnë, por kanë sëmundje në zemrat e tyre.

A është e saktë të thuhet: nëse një grua i përkushtohet kujdesit të familjes, ajo do të mbetet boshe (e papunë) dhe shoqëria do të humbasë gjysmën e energjisë së saj?

Është thelbësore që gruaja ta kuptojë këtë rol madhor në dritën e besimit islam. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”** (*El-Enam: 162*)

Puna e saj (brenda shtëpisë) është adhurim. Nuk është një punë e detyruar ose thjesht një rutinë. Por, është një vepër që ka shpirt, për atë që i kupton qëllimet e jetës dhe arsyet e ekzistencës së njerëzve.

I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selam) ka thënë: ***“Kur gruaja fal pesë kohët e namazit, agjëron muajin e Ramazanit, ruan nderin e saj dhe i bindet burrit të saj, ajo***

hyn prej cilës derë të Xhenetit që dëshiron.”¹¹

Pas këtyre pikave për diskutim, do të diskutohen detyrat e gruas brenda shtëpisë së saj, që përfaqëson rolin e saj kryesor në këtë jetë për të kontribuar në ndërtimin e këtij umeti. Do të na sqarohet se këto janë detyra të mëdha dhe të rëndësishme, të cilat, nëse u jepen haku/e drejta, e konsumojnë shumicën e kohës së saj. Këto detyra janë si vijon:

Detyrat e gruas brenda shtëpisë së saj

E para: Adhurimi i Allahut

Kjo është vetë arsyeja e ekzistencës të njerëzve në tërësi. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për gjë tjetër, por vetëm që të Më adhurojnë.”** (*Edb-Dhariat: 56*)

Prandaj, ne shohim se kryerja e adhurimeve ishte udhëzimi hyjnor për nënat e besimtarëve, kur u urdhëruan të rrinin në shtëpitë e tyre. Allahu ka thënë: **“Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij!”** (*El-Abzab: 33*)

Koncepti i adhurimit është më i gjerë se kryerja e ritualeve praktike, edhe pse këto zënë një pjesë të madhe të adhurimit;

¹¹ Hasen. Ahmedi (1/191). Ky hadith është në “Mexhmaul zeuid” (4/306), dhe autori ka thënë: “Në zinxhirin e tij është Ibn Lahieh dhe ky hadith është hasen.” Shakik ka thënë: Zinxhiri i tij është i shkëputur sipas meje (El-Musned 3/128). Është deklaruar hasen për shkak të transmetimeve mbështetëse nga shejh Albani në “Sahih et-Tergib uet-Terhib”.

megjithatë, kryerja e tyre (adhurimeve) është ndihma më e madhe për një grua që t'i përmbushë detyrat e saj shtëpiake në formë të përkryer. Gruaja e devotshme është ajo që e përmbush rolin e saj në mënyrën e kërkuar. Kjo është baza e edukimit të mirë përmes shembullit, sepse kur gruaja e bën adhurimin me përlësi dhe qetësi, ndikimi është më i madh tek ata që janë në shtëpi, duke përfshirë fëmijët dhe të tjerët. Kur gruaja e përkryen abdesin dhe pastaj qëndron para Zotit e përlurur dhe e nënshtruar, ajo, përmes shembullit, do t'i ushqejë këto kuptime tek fëmijët e saj, përveç sqarimit dhe udhëzimit përmes të folurit.

Megjithëse ky aspekt është i njohur, qëllimet, objektivat dhe ndikimi i tij duhet të bëhen të qarta dhe të kuptohen larg rutinës, e cila është vdekjeprurëse për kuptimet e larta.

E dyta: Gruaja brenda shtëpisë së saj është prehje/strehë dhe burim i stabilitetit për burrin e saj dhe shtëpinë.

Dëshmitë për këtë prehje dhe stabilitet janë:

Fjala e Allahut të Lartësuar: **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni (të gjeni prehje) pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”** (*Er-Rum: 21*)

Përdorimi i fjalës “سكن” (prehje/strehë) dhe domethënia që ajo bart:

Fjala “سكن” bart një kuptim madhështor për stabilitetin, qetësinë

dhe prehjen brenda shtëpisë. Nëse ne do të përpiqeshim të gjenim një fjalë për të shprehur atë që do të thotë kjo fjalë, nuk do të mundnim dhe asnjëherë nuk do të mundemi (në të ardhmen). Kjo është fjala e Zotit të botëve, të cilës nuk mund t'i qaset e kota nga asnjëra anë. Kështu, gruaja është burim i prehjes për bashkëshortin e saj dhe për shtëpinë. Pastaj, Allahu e përshkroi lidhjen (mes burrit dhe gruas) si lidhje e *“dashurisë dhe mëshirës”*.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Është Ai që ju krijoi nga një njeri i vetëm (Ademi), prej të cilit krijoi edhe bashkëshorten e tij (Havanë), që të gjente qetësi tek ajo.”**
(El-Araf: 189)

Domethënë, ai ndihet rehat me të dhe kërkon strehim tek ajo. Le ta kuptojmë sekretin e përdorimit të shprehjes “tek ajo/ato” në këto dy ajete, ku e shohim se fjala prehje/strehë i atribuohet gruas, pikërisht sepse gruaja është vendi për këtë (prehje dhe qetësi). Kështu që, burri dhe të gjithë banorët e tjerë të shtëpisë gjejnë prehje/strehë tek ajo.

Megjithatë, një grua nuk mund të jetë burim i prehjes dhe qetësisë për burrin e saj, derisa të kuptojë të drejtat dhe pozitën e tij dhe pastaj t'i përmbushë të drejtat që ai ka mbi të, duke iu bindur Zotit të saj, me gëzim dhe kënaqësi.

Për këtë arsye, Islami i kushton rëndësi vendosjes së pozitës së burrit, sepse ai është bazamenti (i familjes). I Dërguari i Allahut (sal-IAllahu alejhi ue selem) ka thënë: **“Nëse do të urdhëroja dikë t'i bëjë sexhde dikujt (përveç Allahut), do ta urdhëroja**

gruan që t'i bëjë sexhde burrit të saj.”¹²

Madje, pozita e tij vërtetohet edhe pas vdekjes së tij. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: **“Nuk i lejohet një gruaje që e beson Allahun dhe Ditën e Fundit që të mbajë zji për të vdekurin më shumë se tri ditë, përveçse për burrin e saj. Ajo mban zji për të për katër muaj e dhjetë ditë.”¹³**

Duhet kuptuar se zija është diçka shtesë ndaj periudhës së caktuar të pritjes. Prandaj ky është një tregues për të drejtën e burrit mbi gruan. Në Islam janë ligjësuar rregulla, të cilat e sigurojnë përmbushjen e të drejtave të bashkëshortit dhe kështu shtëpia do të bëhet një vend i qetësisë dhe një ambient i përshtatshëm.

Mirëpo, këto dispozita dhe legjislacione nuk janë të veçanta vetëm për gratë, përkundrazi ato janë për të dy bashkëshortët, por roli i gruas në to është më i madh, sepse ajo është shtylla (e familjes), siç e kemi përmendur. Duke qenë se objekti i diskutimit tonë ka të bëjë me gruan dhe rolin e saj në edukimin e familjes, është e nevojshme të vihen në dukje disa nga përgjegjësitë dhe mjetet e kërkuara për to, që e bëjnë shtëpinë një vend për prehje, siç e dëshiron Allahu.

¹²Sahih. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh. Saktësuar nga shejh Albani në “Sahih Sunen Et-Tirmidhi” (nr. 1158).

¹³Buhariu (nr. 1221), Muslimi (nr. 1487), Tirmidhiu (nr. 1195), Nesaiu (nr. 3533), Ebu Daud (nr. 2299), Ibn Maxheh (nr. 2084), Ahmedi (6/326), Maliku (nr. 1269), Darimiu (nr. 2284).

Prej tyre janë:

1. Bindja e plotë ndaj burrit në çështjet që nuk përfshijnë mosbindje ndaj Allahut:

Kjo bindje është baza e qëndrueshmërisë, sepse autoriteti i takon burrit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë.”** (*En-Nisa: 34*)

Nuk mund ta paramendojmë autoritetin pa pasur bindje. Shtëpia është si një shkollë, ose një administratë. Nëse personi në krye të një organizate ose shkolle, ka punonjës të cilët nuk i binden atij, a mund të vazhdojë puna (pa probleme)? Kështu është edhe shtëpia. Bindja ndaj burrit është një obligim fetar, për të cilën gruaja shpërblehet. Madje, gjejmë se bindja ndaj burrit ka përparësi ndaj adhurimit vullnetar.

Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: **“Gruaja të mos agjërojë duke qenë burri i saj prezënt, veçse me lejen e tij.”**¹⁴ Ky është një tregues i rëndësisë së bindjes ndaj burrit, deri në atë masë sa ajo ka përparësi ndaj agjërimit vullnetar.

2. Kryerja e punëve të shtëpisë të cilat janë baza e jetës familjare, siç është: gatimi, pastrimi (i shtëpisë), larja (e rrobave) dhe të tjera.

Që kjo punë të japë fryte, duhet bërë në mënyrë të përkryer, me qetësi shpirtërore, kënaqësi dhe ndjenjë se ky është adhurim.

¹⁴ Buhariu (nr. 4896), Muslimi (nr. 1026) dhe Ahmedi (2/316).

Ja disa shembuj nga biografia e të Dërguarit (sal-lAllahu alejhi ue selem) nga brezat e parë të këtij umeti:

- Imam Ahmedi ka transmetuar, me zinxhirin e tij të transmetimit, nga Ibn A'bedi se ka thënë: “Ali ibën Ebu Talibi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) më ka thënë: “A të tregoj (diçka) për mua dhe Fatimen (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!)? Ajo ka qenë vajza e të Dërguarit të Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) dhe prej anëtarëve të familjes, ajo ka qenë më e nderuara tek ai; gjithashtu ajo ka qenë gruaja ime. Ajo e rrotullonte mokrën e mullirit, saqë i linte gjurmë në dorë; barte ujë me kacek, saqë ai i linte shenja në qafë; e pastronte shtëpinë, saqë rrobat i pluhuroseshin; e ndizte zjarrin nën tenxhere, saqë rrobat i njolloseshin. Kështu, u dëmtua nga e gjithë kjo punë. Një ditë, sollën disa shërbëtorë tek i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem). Kështu, i thashë asaj: “Shko te i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) dhe kërko prej tij për një shërbëtor që (me shërbimin e tij) të ta largojë vështirësinë në të cilën je. Ajo shkoi te i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) dhe pa disa shërbëtorë tek ai, por u kthye pa kërkuar gjë prej tij.”

Hadithi është më i gjatë, por mes të tjerash ai tregon që i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) i kishte thënë: “*A dëshiron të të tregoj për atë që është më e mirë për ty sesa shërbëtori? Kur të shkosh në shtrat, thuaj: Subhanallah 33 herë, Elhamdulillah 33 herë dhe Allahu Ekber 34 herë.*”

Kështu ajo u largua duke thënë dy herë: “Unë jam e kënaqur me Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”¹⁵

I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) nuk ia mohoi këtë përpjekje (asaj), pavarësisht faktit se kush ishte ajo në virtyte dhe nderit që gëzonte. Përkundrazi, ia miratoi atë dhe e udhëzoi drejt një akti adhurimi, përmes të cilit asaj do t'i lehtësohej kryerja e këtyre punëve dhe i tregoi se kjo është më e mirë për të, sesa një shërbëtor.

- Ibën Is'hak ka transmetuar, me zinxhirin e tij të transmetimit, prej Esmā bint Umejs, se ka thënë: “Kur u vranë Xhaferi dhe shokët e tij, i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) erdhi te unë. Para së të vinte, unë i kisha regjur dyzet lëkura, kisha ngjeshur brumin dhe i kisha larë e lyer me parfum fëmijët e mi. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) më tha: *“M'i sill mua fëmijët e Xhaferit.”* (Ajo tha:) Kështu, i solla ata. Ai u mori erë atyre dhe i rrodhën lotë. I thashë: “I bëfsha kurban për ty nënën dhe babanë tim, o i Dërguar i Allahut. Çfarë të bëri të qash? A të ka ardhur ndonjë lajm rreth Xhaferit dhe shokëve të tij?” Ai (sal-lAllahu alejhi ue selem) tha: *“Po. Ata janë vranë sot.”*¹⁶

¹⁵ Origjina e këtij hadithi është te Buhariu (nr. 2945) dhe Muslimi (nr. 2727). Por, ky version i transmetimit është transmetuar nga Imam Ahmedi në Musnedin e tij dhe është deklaruar i dobët në kontrollimin e musnedit të tij (botimi “Er-Risaleh”), për shkak të gjendjes reale të Ibn A’bedit dhe Ebul Uerdit, duke qenë të panjohur.

¹⁶ Transmeton Imam Ahmedi (1/370). Ky hadith është deklaruar të jetë i dobët në kontrollimin e Musnedit të Imam Ahmedit (botimi “Er-Risaleh”).

3. Përgjigjja ndaj burrit të saj në atë që Allahu ia ka lejuar atij.

Ka thënë i Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem): *“Nëse burri e fton gruan në shtratin e tij dhe ajo refuzon të shkojë, ndërkohë që ai e kalon natën i zemëruar me të, engjëjt e mallkojnë atë (gruan) deri në mëngjes.”*¹⁷

Madje është e preferuar që ajo të zbukurohet dhe t’i afrohet atij para se ai t’ia kërkojë këtë gjë. Vërtet, është për të ardhur keq që disa gra zbukurohen kur dalin jashtë shtëpisë (edhe pse u është ndaluar ta bëjnë këtë) më shumë sesa zbukurohen për burrat e tyre (e që janë urdhëruar të bëjnë një gjë të tillë). E gjithë kjo e tregon paditurinë (e saj) për përgjegjësinë (mbi të), ose se ajo nuk po e ndjek ligjin e Allahut.

Që një grua të zbukurohet për burrin e saj dhe ta bëjë këtë në mënyrën më të mirë të mundshme, ka ndikim të madh në stabilitetin e shtëpisë; sepse burri do ta ruajë nderin e tij, do të jetë i kënaqur me gruan e tij, nuk do të ndihet i dështuar e i privuar dhe kështu arrin qëndrueshmëri psikologjike.

Sa e sa burra bëjnë jetë të paqëndrueshme për shkak të ndjenjës së privimit, sepse gruaja nuk i kushton vëmendje këtij aspekti, ose ajo nuk di ta kryejë atë siç duhet. Le ta kuptojë gruaja rolin e saj sa i përket kësaj çështjeje, pastaj le të mendojë dhe të hulumtojë se si ta kryejë atë.

¹⁷ Buhariu (nr. 3265) dhe Muslimi (nr. 1436), Ebu Daudi (nr. 2141), Ahmedi (2/439) dhe Darimiu (nr. 2228)

4. Ruajtja e sekreteve dhe nderit të tij.

Gruaja nuk duhet t'i ekspozohet fitneve (tundimeve) apo shfaqjes së bukurive të saj. Ajo nuk duhet ta marrë si të lehtë çështjen e shfaqjes së vetes para burrave të huaj në derën e shtëpisë, ose në dritare, ose jashtë shtëpisë. Ajo duhet të jetë modeste kur del jashtë shtëpisë.

Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Sa i përket të drejtës tuaj mbi gratë tuaja, ato nuk duhet të lejojnë atë që ju nuk e pëlqeni të ulet në shtratin tuaj, e as të lejojnë atë që ju nuk e pëlqeni të hyjë në shtëpitë tuaja.”*¹⁸

Kjo ofron siguri për moralin dhe mirëqenien etike të shtëpisë, burrit ia shton mirëbesimin dhe fëmijët edukohen që të jenë të ndershëm. Një shtëpi në të cilën tregohet neglizhencë në ndonjërin nga këto çështje, asnjëherë nuk do të jetë vend i prehjes dhe i stabilitetit.

5. Ruajtja e pasurisë së tij.

Ka thënë Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem): *“Gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të saj dhe përgjegjëse për tufën (kopenë) e saj.”*¹⁹

¹⁸Hasen. Tirmidhiu (nr. 1163) dhe Ibn Maxheh (nr. 1851). Ky hadith është cilësuar hasen (i mirë) nga shejh Albani në “Sahih Sunen et-Tirmidhi” (nr. 1163)

¹⁹Buhariu (nr. 853), Muslimi (nr. 1829), Tirmidhiu (nr. 1705), Ebu Daudi (nr. 2928) dhe Ahmedi (2/121).

Gjithashtu, ka thënë: *“Gratë më të mira ndër ngasëset (kalërueset) e deveve²⁰ janë gratë e devotshme të fisit Kurejsh. Ato janë më të dhembshurat për fëmijën kur është i vogël dhe që më së shumti e ruajnë pasurinë e burrit.”²¹*

Çështja e pasurisë është një çështje me rëndësi dhe një sërë çështjesh lidhen me të. Prej tyre:

- a) Duke e ruajtur pasurinë, arrihet deri te përmirësimi (rendi) në shtëpi.
- b) Të mos shpërdorohet dhe shkapërderdhet pasuria.
- c) Të mos ngarkohet burri financiarisht me shpenzime që ai nuk mund t'i përballojë.

Çështjet financiare sot kanë një sistem dhe llogari. Ka kaq shumë mjete dhe metoda që i sigurojnë familjes një jetë të rehatshme dhe pa kosto financiare. Është bërë një art që studiohet. Prandaj, a është gruaja e vetëdijshme për rolin e saj në gjithë këtë?

6. Trajtimi i mirë

Burri është përgjegjës (për familjen), ndaj duhet që çdo trajtim të burojë nga ky këndvështrim. Prej formave të ndryshme të trajtimit të mirë, janë:

- a) Të durojë ndaj gabimeve të tij.

²⁰Domethënë ndër gratë e arabëve, sepse arabët ishin të njohur për ngasjen/kalërimin e deveve.

²¹Buhariu (nr. 4794), Muslimi (nr. 2527) dhe Ahmedi (2/449).

- b) Ta qetësojë kur ai zemërohet.
- c) Ta bëjë të ndihet i dashur dhe i vlerësuar.
- d) T'i flasë atij fjalë të mira dhe t'i japë buzëqeshje të sinqerta. Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Buzëqeshja në fytyrën e vëllait tënd është sadaka (lëmshë).”*²²
Po nëse kjo veprohet nga gruaja për burrin e saj?
- e) T'i kushtojë vëmendje çështjeve të tij personale, si: ushqimi, pija dhe veshmbathja, sa i përket llojit (të tyre) dhe kohës (së shërbimit).

Gruaja duhet ta dijë se, kur ajo i kryen këto gjëra, kjo nuk përbën një sulm ndaj personalitetit të saj ose degradim të pozitës së saj. Përkundrazi, kjo është rruga drejt lumturisë dhe kurrë nuk do të ketë lumturi, përveçse nën hijen e burrit të cilin ajo e trajton mirë. Ky është caktimi i Allahut, të Lartësuarit, të Gjithëdijshmit.

Allahu thotë: **“Meshkujt kanë autoritet mbi gratë.”**

(En-Nisa: 34)

Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Nëse do të urdhëroja dikë që t'i bëjë sexhde dikujt tjetër, do ta urdhëroja gruan t'i bëjë sexhde burrit të saj.”*²³

Prandaj, gruaja duhet t'i kuptojë objektivat e legjislacionit të Islamit dhe të mos mashtrohet (tundohet) nga propaganda e

²²Sahih. Transmetuar nga Tirmidhiu (nr. 1956). Saktësuar nga shejh Albani në “Sahih Sunen Et-Tirmidhi” (nr. 1956).

²³Sahih. Transmetuar nga Tirmidhiu (nr.1159) dhe Ibn Maxhe. Ky hadith është saktësuar nga shejh Albani në “Sahih Sunen Et-Tirmidhi” (nr. 926).

reme dhe motoja e saj le të jetë “dëgjuam dhe u bindëm”.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur t’ju vijë udhëzim nga ana Ime, kush do ta pasojë udhëzimin Tim, as nuk do të humbë, as nuk do të bjerë në mjerim.”** (Ta Ha: 123)

7. Organizimi i kohës.

Sigurohu për ta organizuar kohën tënde, në mënyrë që puna jote të jetë një kënaqësi, dhe bëje shtëpinë tënde të jetë vazhdimisht si një kopsht: e pastër dhe e organizuar. Shtëpia e përfaqëson gruan që është përgjegjëse për të. Shtëpia do të ketë pamjen më të bukur përmes pastërtisë dhe organizimit, edhe nëse orenditë janë modeste. E kundërta është po ashtu e vërtetë. Kur burri kthehet në shtëpi nga puna dhe fëmijët prej mësimeve të tyre, të gjithë janë të lodhur, por e gjejnë shtëpinë të pastër dhe të organizuar, atëherë kjo do t’ua lehtësojë lodhjen dhe rraskapitjen atyre. Gjithashtu, e kundërta është e vërtetë. Shtëpia e pastër dhe e organizuar është prej shkaqeve më të rëndësishme që ajo të jetë vend për prehje dhe relaksim.

8. T’i qëndrosh burrit pranë.

Kur shfaqen situata dhe kriza, e sa të shumta janë ato në këtë jetë, jepi atij kurajë dhe këshilla. Në kohë të krizave, bëje atë të vrapojë për në shtëpi, te gruaja e tij, te burimi i prehjes së tij dhe jo të ikë prej teje (dhe shtëpisë). Kjo është një ndër arsytet më të mëdha të harmonisë dhe kështu shtëpia bëhet një vend i prehjes.

9. Të jesh e sinqertë me burrin.

Bëhu e sinqertë me të në çdo gjë, posaçërisht në atë që ndodh kur ai nuk është në shtëpi. Qëndro larg gënjeshtëris dhe fshehjes (së gjërave prej tij), sepse nëse e mashtron (i fsheh ndonjë gjë) një herë, kjo nuk do të zgjasë përherë, dhe atëherë do të humbësh besimin e tij. Nëse besimi humbet, shtëpia nuk do të jetë një vend i prehjes, e as një vend për edukim të drejtë.

10. Si të sillësh kur ndodh një mosmarrëveshje?

Në fund, dije që ne jemi njerëz, kështu që dobësia është e pashmangshme dhe patjetër që do të ketë mosmarrëveshje për disa çështje, por ajo që ka rëndësi është se si trajtohen këto mosmarrëveshje. Meqë është normale që të ndodhë ndonjë mosmarrëveshje, nuk është e lejuar që çdo mospajtim të kthehet në një problem që mund ta shembë ekzistencën e shtëpisë. Ja, disa këshilla, të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje kur ndodh një mosmarrëveshje:

- Shmang vazhdimin e diskutimit në gjendje inati dhe qëndro larg kësaj derisa të qetësohen nervat.
- Përdore metodën e hulumtimit, jo atë të debatit; identifikojë problemin dhe shkaqet e tij.
- Shmang ndërprerjen (kur ai është duke folur) dhe dëgjo me vëmendje.
- Duhet dhënë ndjenja të mira dhe duhet të bëhet e qartë se secila palë e do tjetrën, por dëshiron ta zgjidhë problemin.
- Duhet të jeni të përgatitur për kompromis (lëshime), pasi

që këmbëngulja e secilës palë për mendimin (qëndrimin) e vet, çon në një përkeqësim të situatës dhe mund të çojë në divorc.

Këto janë disa nga gjërat që duhet t'i bëjë gruaja në shtëpinë e saj, në mënyrë që të marrë pjesë në ndërtimin e një banese (strehe) të vërtetë; një shtëpi në të cilën burri jeton në paqe, siguri dhe stabilitet dhe është produktiv për umetin islam; një shtëpi në të cilën fëmijët rriten me një edukim të shëndoshë, duke përmirësuar kështu umetin përmes përmirësimit të brezave të ardhshëm. Dy bashkëshortët janë themeli i familjes, dhe nëse marrëdhënia mes tyre është e keqe, atëherë nuk do të ketë stabilitet në shtëpi.

BËRJA E FAMILJES, NË KUPTIMIN E SAJ MË TË GJERË, VEND PËR PREHJE DHE QETËSI

Prej detyrave që gruaja duhet t'i veprojë brenda shtëpisë së saj, në mënyrë që ta përmbushë rolin e saj në ngritjen e familjes, është dëshira e saj për ta bërë familjen burim të prehjes dhe stabilitetit në kuptimin më të gjerë. Diskutimi në paragrafët më lart ka prekur familjen në kuptim të ngushtë: burri, gruaja dhe fëmijët. Por, familja është më e gjerë se kaq, meqë ajo përbëhet nga nëna, babai, vëllezërit dhe motrat, të cilët kanë të drejta, pavarësisht se a janë duke jetuar me burrin brenda shtëpisë apo jo. Ata duhet që t'i përmirësojnë marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe të ketë harmoni mes tyre, pasi shumë dispozita lidhen me këtë, duke përfshirë nderimin e prindërve dhe ruajtjen e lidhjeve familjare.

Gruaja ka një rol të rëndësishëm në gjithë këtë. Sa e sa gra ka që, për shkak se e kanë kuptuar këtë aspekt dhe kanë pasur frikë Allahun, janë bërë shkak që të ruhen lidhjet familjare mes burrit dhe nënës, babait, fëmijëve dhe të afërmeve të tij? Kështu, ajo u bë mjet mirësie që bashkon familjen për të mirë. Në anën tjetër, sa e sa gra ka që nuk e dinë detyrën e tyre në këtë aspekt, ose e dinë, por nuk e kanë frikë Allahun dhe bëhen shkak që familja të përçahet dhe si pasojë vjen mosrespektimi i prindërve dhe shpëputja e lidhjeve familjare. E gjithë kjo ndodh për shkak të mosnjohjes së rolit të gruas në këtë aspekt dhe mos përmbushjes së tij.

Rritja e fëmijëve.

Një nga fushat, në të cilën roli i gruas në ngritjen e familjes është i dukshëm, është rritja e fëmijëve. Kjo është prej fushave më të rëndësishme dhe më vendimtare, për dy arsye:

1. Sepse është burim i orientimit (udhëzimit) të fëmijës dhe umeti formohet prej fëmijëve. Ashtu siç është gjendja e fëmijës dhe edukimi i tij sot, ashtu do të jetë gjendja e umetit në të ardhmen. Nga kjo mund ta kuptojmë se të gjithë pjesëtarët e këtij umeti do të kalojnë nëpër shkollën e nënës.
2. Për shkak se fëmija ka shumë të panjohura, për të vlen që ai është i qartë dhe i paqartë, i lehtë dhe i vështirë, prandaj kujdesi për të dhe rritja e tij kërkon përpjekje dhe nuk është e lehtë. Këtë do ta shpjegojmë në vijim.

Kujdesi ndaj fëmijës është përgjegjësi e të dy prindërve bashkë. Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Secili prej jush është bari dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është bari i familjes së tij dhe përgjegjës për familjen e tij. Gruaja është bareshë e shtëpisë së burrit (dhe e fëmijëve) dhe përgjegjëse për ta.”*²⁴

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“O ju që keni besuar! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Et-Tabrim: 6)

²⁴ Buhariu (nr. 853), Muslimi (nr. 1829), Tirmidhiu (nr. 1705), Ebu Daudi (nr. 2928) dhe Ahmedi (2/121).

Kur e analizojmë realitetin e situatës, konstatojmë se burri kalon vetëm pak kohë brenda shtëpisë dhe me fëmijët e tij. Kjo është në raport me kohën si tërësi (sa i përket sasisë). Ndërsa, sa i përket cilësisë (se si e kalon kohën me ta), atëherë gjatë kësaj kohe ai është i rraskapitur nga puna dhe ka nevojë për pushim. Ai nuk është në gjendje të mendojë për gjendjen e fëmijëve. Kështu na bëhet e qartë se gruaja e ka rolin më të madh në këtë gjë dhe se kjo është përgjegjësia e saj.

Buhariu transmeton nga Xhabir ibn Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë:

“Babai im vdiq dhe la pas vetes shtatë apo nëntë vajza, kështu që u martova me një vejushë. I Dërguari i Allahut (sal-lAllahu alejhi ue selem) më pyeti: “Dëgjova se je martuar, o Xhabir?” U përgjigja: “Po.” Ai më pyeti përsëri: “(A je martuar) me vajzë të virgjër apo me vejushë?” “Me vejushë”, - ia ktheva. Pastaj, ai tha: “Pse jo me një vajzë të re me të cilën ti do të luaje e ajo do të luante me ty; ti do ta bëje të qeshë e ajo do të të bënte ty të qeshësh?” Atëherë, unë i thashë: “Abdullahu vdiq dhe la pas vajza. Nuk preferova të sjell në shtëpi dikë si ato. Kështu që, u martova me një grua e cila do të mund të kujdesej për to dhe t’i edukonte.” Ai (sal-lAllahu alejhi ue selem) tha: “Allahu të bekoftë!” Ose tha: “Për mirë qoftë!”

Ky hadith tregon që gruaja është bashkëpjesëmarrëse me burrin e saj në rritjen e fëmijëve. Në fakt, roli parësor është i saj (siç e pamë në këtë hadith): “Një grua që do të mund të kujdesej dhe t’i edukonte ato.”

Çështje që lidhen me shëndetin e fëmijës

Motër, përmbushja e kësaj detyre madhështore kërkon prej teje që ta kuptosh plotësisht atë, për ta kryer në mënyrën e duhur. Vërtet, kujdesi ndaj fëmijës dhe rritja e tij me edukatë të mirë, kërkon njohuri për disa aspekte që lidhen me fëmijën dhe unë do të paraqes disa prej tyre:

Së pari: Aspekti shëndetësor. Fëmija i sëmurë, ose i dëmtuar, nuk do të jetë individ i plotë dhe i dobishëm për umetin. Për këtë arsye, gjëja e parë që duhet ta bëjë gruaja është t'i kushtojë rëndësi shëndetit të fëmijës së saj. Për këtë temë janë shkruar një sërë librash. Prej tyre është edhe libri “Kujdesi për shëndetin e fëmijës” nga Dr. Nebih Gubrah. Ai e ka paraqitur kujdesin shëndetësor të fëmijëve në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë, që çdo grua me një sasi të vogël njohurish mund ta kuptojë. Ndër shënimet që lidhen me shëndetin e fëmijëve janë:

1. Gruaja shtatzënë kujdeset për shëndetin e saj, sepse të qenët e shëndetshme do të thotë që fëtusi do të jetë i shëndetshëm. Është e nevojshme që të merren masat e duhura për këtë.
2. Pas lindjes, fëmija kalon në disa faza. Çdo fazë është një situatë unike dhe e ka një kujdes shëndetësor të llojit të veçantë. Këto faza do t'i përmbledhim më poshtë:

Faza e parë: I porsalinduri gjatë muajit të parë. Në këtë moshë shqisat janë të mprehta dhe të ndjeshme. Nëna patjetër duhet t'i dijë cilat janë aspektet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme

të kësaj faze. Gjithashtu, duhet të dijë si ta trajtojë fëmijën, cili është vendi i përshtatshëm për të fjetur fëmija, cila është mënyra e duhur për ta ushqyer me gji, cila është veshja (e përshtatshme) dhe të tjera.

Faza e dytë: Kjo fazë vjen pas së parës dhe është mosha e gjirit (kur foshnja ushqehet vetëm me qumështin e nënës) dhe kur fëmija fillon të ecë e të flasë. Gruaja duhet t'i dijë çështjet që lidhen me mirëqenien e fëmijës gjatë kësaj periudhe. Kur fëmija përpigjet të ecë, nuk duhet të ngarkohet më shumë se sa mund të përballojë dhe nuk ka nevojë ta ndihmohet me diçka për të ecur, përkundrazi lihet të veprojë sipas aftësisë së tij.

Faza e tretë: mosha parashkollore, gjatë së cilës ai përgatitet për shkollë, duke marrë parasysh aftësitë e fëmijës dhe duke e bërë shkollën dhe leximin tërheqës për të.

Më pas vjen faza e fëmijërisë së mesme dhe adoleshencës, gjatë së cilës kërkohen përpjekje të mëdha për edukimin e fëmijës. Gjithashtu, mbaji mend disa çështje shëndetësore, për të cilat duhet të kesh përvojë. Ato janë:

1. Cilat janë vaksinat e fëmijëve dhe kur duhen vaksinuar ata?
2. Rritja e shëndetshme e fëmijës.
3. Të jesh në dijeni të talenteve dhe aftësive të fëmijës.
4. Argëtimi i fëmijës dhe siguri i lodrave për të. Rëndësia e lojës në jetën e fëmijës nuk është thjesht për argëtim, por është një mjet për mësimin dhe zhvillimin e aftësive të fëmijës. Për çdo moshë ka lodra specifike që janë të

përshtatshme për të. Nëse fëmijës i jepet një lodër, e cila është nën nivelin e tij mendor, ai nuk do të kujdeset për të. Ndërsa, nëse atij i jepet një lodër, e cila është mbi nivelin e tij (mendor), ai do të ketë nevojë për më shumë përpjekje se mundësitë e tij dhe ndoshta do ta prishë atë. Po ashtu ka lodra që janë të dëmshme, të cilat duhet të shmangen dhe të kemi kujdes nga to.

5. Cilat janë shkaqet dhe si duhet të trajtohet urinimi i pavullnetshëm dhe lagia e shtratit natën?
6. Mjedisi dhe orientimi (edukimi) luajnë në rol të rëndësishëm tek fëmijët mëngjarash.
7. Çdo moshë ka aksidente të rrezikshme dhe ti duhet të dish se si ta mbrosh fëmijën tënd nga to. Disa nga këto aksidente janë: rrëzimi, gëlltitja (e gjërave), helmimi, djegia, shtypja (nga dikush tjetër) e të tjera.²⁵

Ky është vetëm një aspekt i kujdesit ndaj fëmijëve dhe gruaja duhet të pyesë veten se a ka informata dhe përvojë të mjaftueshme sa i përket kësaj? Qëllimi me përmendjen e tyre nuk është shtjellimi (i hollësishëm) dhe paraqitja e një qasjeje mjekësore, pasi nuk është vendi për këtë, por vetëm të shërbejnë si një tregues i faktit që kjo çështje nuk është aq e lehtë sa mendohet.

Ndërsa shpjegimi i aspektit tjetër, atij të edukatës morale, të formimit të tij në mënyrë të drejtë, të rrenjosjes së zakoneve të mira tek ai dhe mbajtjes së tij larg zakoneve të këqija, në mënyrë

²⁵ Shiko librin: “Kujdesi për shëndetin e fëmijës” nga dr. Nebih Gubrah

që të rritet si fëmijë i mirë (i devotshëm), që do jetë prehje për sytë e prindërve të tij, kërkon një sërë ligjëratash, sepse është një temë komplekse. Kushdo që është përgjegjës për rritjen (edukimin) e një fëmije, duhet të dijë se cilat janë karakteristikat e fëmijës, në mënyrë që ta trajtojë atë me dije të sigurt. Pastaj të dijë se cilat janë mjetet më të mira dhe më efektive për ta rritur atë. Duhet të kuptosh, motër, se në çdo moshë të jetës së një fëmije, ai ka një natyrë të veçantë dhe secila (moshë) ka mjetet e veta edukative. Ka shumë libra që janë shkruar në këtë temë. Nëse ti beson se kjo është një pjesë e rëndësishme e rolit tënd të madh në ngritjen e familjes, atëherë duhet të kesh njohuri për të, që të kesh mundësi ta kryesh këtë mision madhështor në mënyrë të plotë. Më poshtë do t'i përmend shkurtimisht disa pika në lidhje me këtë çështje:

Karakteristikat e një fëmije

Kushdo që dëshiron të rrisë një fëmijë sipas një qasjeje të shëndoshë edukative, duhet t'i njohë këto karakteristika. Prej tyre janë:

1. Aftësia/prirja (për pranim).

Fëmija është si një fletë e zbrazët, ku nuk është rrënjosur ndonjë sjellje apo ide. Ai ka aftësinë/prirjen që t'i pranojë ndryshimet dhe udhëzimet, ashtu si një degë e butë, të cilës mund t'i japësh formë sipas dëshirës. Prandaj, një grua duhet të jetë e vetëdijshme për rolin e saj në këtë çështje.

2. Të menduarit pamor.

Nëna nuk duhet të brengoset nëse fëmija nuk kupton disa gjëra, sepse çdo gjë që ka përballë, ai e lidh me të menduarit pamor. Kështu nëse i thua atij “3+3”, ai mund të mos kuptojë, por vendosi tre lapsa pranë tij e pastaj edhe tre (tjerë), ai do të thotë “gjashtë”, e kështu me radhë. Kjo është arsyeja pse fëmija nuk merret në përgjegjësi deri pas pubertetit. Në mënyrë që të rritet fëmija me cilësi të lavdërueshme, është e nevojshme që atyre t’u paraqiten shembuj praktik.

3. Individualizmi dhe egoizmi.

Kjo është ndjenja se çdo gjë është e tij. Roli i edukatorit është ta çrrënjosë këtë prej tij, në mënyrë që ai t’i respektojë të tjerët.

4. Fëmija ka nevoja të domosdoshme që, nëse nuk i sigurohen, rritja e tij do të pengohet, ose do të formohen tek ai sjellje të këqija. Prej tyre janë:

a) Dashuria dhe siguria nga prindërit e tij.

b) Vlerësimi dhe besimi. Nëse nuk respektohet dhe nuk i besohet, ai do të zhvillojë mungesë vetëbesimi.

c) Shoqërimi. Ai patjetër do të shoqërohet me fëmijët e tjerë. Prandaj, për të shmangur mospërputhjen, duhet që shokët e tij të zgjidhen prej fëmijëve që janë edukuar me kujdes nga prindërit e tyre.

Përshkrimi i rritjes dhe edukimit të fëmijës

Të gjitha metodat, të cilat i përdorim për të rritur dhe edukuar një fëmijë, kthehen te njëra nga këto qasje:

1. *Urdhurat gojore*. Kjo metodë bazohet në urdhër të thjeshtë dhe nuk është shumë efektive. Fatkeqësisht, përdoret nga shumë njerëz.
2. Urdhrave gojore u shtohet edhe një çështje tjetër, si *këshilla* apo *“inkurajimi dhe shkurajimi”*. Kjo metodë është më efektive se ajo e mëparshme.
3. *Përmes vëzhgimit dhe imitimit*. Kjo është metoda më e rëndësishme dhe më vendimtare. Këtu luan rol shembulli dhe sjellja e nënës në shtëpi; ashtu siç sillet nëna, do të jetë edhe gjendja e fëmijës. Ajo nuk mund t’ia mësojë atij sinqeritetin dhe ta ndalojë nga gënjeshtria, nëse vetë gënjen në praninë e tij.

Përveç kësaj, ka disa udhëzime të përgjithshme për rritjen e fëmijës, prej të cilave:

- Goditja/rrahja dhe keqpërdorimi i saj. Nuk ka dyshim se goditja është një metodë edukative, por si dhe kur duhet të përdoret? Kjo është një çështje me rëndësi.
- Frikësimi i fëmijës me “lugatin” dhe ndikimi i tij në psikikën e fëmijës.
- Edukimi i tij (në mënyrë të balancuar) mes përkëdhelisë dhe ashpërsisë.
- Ta mbash fëmijën larg fëmijëve të cilët janë të pasjellshëm.
- Ndjekja e fëmijës në mësimet e tij.

- Edukimi i vajzës që të jetë e turpshme.
- Edukimi i fëmijës përmes vështtrimit (të prindërve) dhe mësimit i fëmijës me të.
- Nuk duhet të ketë kontradikta ndërmjet bashkëshortëve kur ta këshillojnë (udhëzojnë) fëmijën, pra nuk duhet që njëri ta urdhërojë, e tjetri ta ndalojë për të njëjtën vepër.
- Nuk duhet të ketë kontradiktë mes fjalëve dhe veprave (të prindërve).
- Mbikëqyrja e fëmijëve në shtëpi, kur ata nuk janë të vetëdijshëm.
- Prindi (nëna) duhet të lutet për ta (edhe në rastet kur e zemërojnë) dhe të mos përdorë fjalë të këqija (fyese).

Nuk ka dyshim se çdo pikë e mësipërme ka nevojë për shpjegim dhe shtjellim. Por, këtu nuk është vendi për t'i shpjeguar mjetet dhe metodat e rritjes dhe edukimit të fëmijës. Unë e përmenda këtë vetëm për të sqaruar se detyra e nënës në rritjen e fëmijës nuk është punë e lehtë. Por, është një punë që kërkon njohuri dhe përpjekje të vazhdueshme.

Punë të tjera

Shembuj të disa punëve që kanë dobi financiare dhe edukative për familjen.

Katër fushat, të cilat janë përmendur më lart, janë fushat më të rëndësishme të punës së gruas në shtëpi, përmes të cilave ajo merr pjesë në përgatitjen e shëndoshë të familjes. Por, ka edhe punë tjera që gruaja mund t'i kryejë dhe të cilat kanë dobi

financiare dhe edukative për familjen, nëse gruaja ka ndonjë kohë të lirë (në dispozicion) dhe pasi t'i ketë përmbushur detyrat e saj kryesore që janë përmendur më herët. Këto punë janë të shumta dhe nuk kanë numër të kufizuar. Ato ripërtërihen (përsëriten) sipas kushteve financiare e sociale të familjes dhe sipas përpjekjeve dhe të menduarit të gruas. Si shembuj (për këto punë), por pa u kufizuar, mund të përmendim:

Qepja e rrobave.

Sa para i shpenzon familja në këtë gjë? Shto këtu edhe efektet e tjera negative, sepse gruaja kalon shumë kohë para rrobaqepësit, i cili është i panjohur, duke u përpjekur t'i shpjegojë atij saktë se çfarë dëshiron. Në të shumtën e rasteve rrobaqepësi është një i huaj që i kupton disa e fjalë, por nuk e kupton shumicën e tyre. Përveç kësaj, kjo sjell në shtëpi edhe stile me modë që bien ndesh me ligjin islam, si dhe me moralin dhe shijen shoqërore²⁶.

Është e çuditshme që një grua del të punojë jashtë shtëpisë për të fituar disa rijalë²⁷ dhe më pas kjo rrogë shpenzohet te rrobaqepësi dhe për dado që kujdeset për fëmijët.

Nëse një grua do t'i përkushtohet rritjes së fëmijëve të saj dhe kohën e lirë do ta kalonte për të qepur rrobat e saj, do të shihni se sa shumë do t'i shërbente këtij umeti. Nuk është çështja te

²⁶Autori është duke folur për shtetin e Arabisë Saudite.

²⁷Monedha e Arabisë saudite.

një shumë e parave, por për ruajtjen e brezave të këtij umeti dhe për ruajtjen e moralit të tyre. Kjo nuk vlen në të gjitha rastet, pasi e kemi përmendur më lart se umetit i duhen gratë që punojnë në fusha të caktuara, të cilat vetëm ato mund t'i kryejnë, por dallimi qëndron nëse ky është një përjashtim apo është rast i përgjithshëm.

Punimi i gjërave dekorative (zbukuruese).

Një nga punët që gruaja mund të bëjë në shtëpi janë punimet artistike dhe format estetike. Dëshira për të bukurën është një gjë e krijuar në fitreh (natyrshmëri). Dashuria e një personi për pamjet e bukura dhe format e mrekullueshme është e lejuar. Pra, një person ka të drejtë t'i dëshirojë dhe t'i punojë ato për aq sa kjo nuk përfshin teprim apo ndonjë gjë që është e ndaluar nga ana e fesë, siç është prania e imazheve në to. Shumë nga këto gjëra dekorative punohen nga gratë. Disa njerëz i duan shumë këto gjëra dhe shpenzojnë shumë pasuri për t'i arritur ato. Po sikur gruaja të përfitonte pak nga koha e saj (e lirë) dhe të punonte disa nga këto punime artistike dhe kështu t'i kursente këto para? Kjo fushë prej punëve (të gruas) nuk është e një rëndësie të madhe, por e përmenda për ta sqaruar se një grua ka hapësirë të mendojë për shfrytëzimin e kohës së lirë në gjëra përmes së cilave i bën dobi vetes dhe familjes së saj.

Pasi i paraqitëm këto punë të rëndësishme që i bën gruaja brenda shtëpisë dhe përmes tyre ajo merr pjesë në ngritjen e familjes, atëherë a është e saktë të thuhet se, nëse gruaja rri në shtëpinë e saj dhe u përkushtohet këtyre detyrave, mbetet e

papunë? Dhe, a është i saktë mendimi i atyre që thonë: Nëse një grua qëndron në shtëpi, kjo e bën gjysmën e shoqërisë të papunë?!

Cilët janë matësit e saktë për papunësinë? Të dalë gruaja jashtë shtëpisë dhe të lërë detyrën më të shenjtë dhe më të rëndësishme në mënyrë që të kryejë rolin e nëpunësit, që çdo i ri i papunë mund ta bëjë?! Duke dalë nga shtëpia gruaja, kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të saj ia lë shërbëtores ose dados. Pastaj, ajo kthehet në shtëpi, për t'i shpenzuar ato para, për të cilat e la përgjegjësinë kryesore, për shërbëtoresh, shoferin dhe në dyqanet e rrobaqepësisë. Pra, ka sëmundje në zemra dhe largim nga fitreja.

Ky është regres i qenies njerëzore, sepse ata po largohen nga rruga e Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.”** (Ta Ha: 124)

Disa nga ata që janë ndikuar nga aktualiteti, i janë nënshtruar presionit të tij dhe nuk mendojnë ndryshe, veçse përmes disa kushteve të caktuara shoqërore, dhe mund të thonë: “Ky është fjalim emocional dhe është shumë larg realitetit praktik.”

Vështrim mbi gjendjen reale të grave në perëndim.

Unë u them njerëzve të tillë: Ejani dhe dëgjoni thirrjet e disa prej perëndimorëve që janë tmerruar nga gjendja në të cilën kanë arritur shoqëritë e tyre, kur gruaja ka dalë jashtë dhe e ka lënë shtëpinë. Edhe pse Perëndimi ka avancuar materialisht, ka

pësuar regres në aspektin shoqëror dhe moral, e si rrjedhojë civilizimi i tij është pranë kolapsit. Mendimtarë perëndimorë kanë filluar të paralajmërojnë për këtë rrezik dhe tërheqin vërejtjen për gjendjen në të cilën ka arritur familja dhe vet gruaja, pasi ajo është përfshirë në fuqinë punëtore jashtë shtëpisë.

Auguste Comte, themeluesi i sociologjisë, thotë: “Është detyrë për burrin që ta furnizojë gruan. Ky është ligji natyror i llojit tonë njerëzor dhe është një ligj që i përshtatet jetës origjinale shtëpiake për gjininë e dëshiruar (gruan). Ky lloj detyrimi i ngjan atij që detyron klasën punëtore të njerëzve të punojnë për të ushqyer intelektualët në mesin tyre, në mënyrë që këta të fundit t’i përkushtohen me gatishmëri të plotë përmbushjes së detyrave të tyre bazike. Megjithatë, detyrat e gjinisë së punës nga ana materiale (burrit) ndaj gjinisë së dëshiruar (gruas), janë më të shenjta se ato, për faktin se detyrat e gruas kërkojnë jetën shtëpiake.”²⁸

Për më tepër, një shkrimtare e njohur perëndimore, në një artikull të botuar në gazetën (The Eastern Mail), më 10 maj 1901, tha: “Që vajzat tona të punojnë në shtëpi si shërbëtore, ose ngjashëm me to, është më mirë dhe fatkeqësi më e vogël sesa ato të punojnë në fabrika, ku vajza ndotet me papastërti që i heqin përgjithmonë shkëlqimin e jetës së saj. Sikur vendet tona të ishin si vendet muslimane, ku njerëzit si tipar kanë modestinë, dëlirësinë dhe pastërtinë. Shërbëtorja dhe robi

²⁸ “El-Mer’a bejnel-Fikhi uel-Kanun”, fq. 22.

gëzojnë jetesën më të rehatshme dhe trajtohen ashtu siç trajtohen fëmijët e shtëpisë dhe nuk u cenohet nderi. Po, është një turp për vendin anglez, që vajzat e tyre janë shembull i imoralitetit, si pasojë e përzierjes së shpeshhtë të tyre me burra të huaj. Ç'është puna me ne që nuk përpiqemi ta bëjmë vajzën të punojë (në një ambient) që përputhet me fitren (natyrën) e saj, siç është qëndrimi dhe puna në shtëpi, dhe punën e burrave t'ua lëmë burrave, (në mënyrë) që ta mbrojmë nderin e saj?"²⁹

Shikoni se çfarë tha kjo grua në fillimin e këtij shekulli (shek. 20). Gjendja e grave perëndimore është përkeqësuar prej atëherë. Ndaj, ku janë mendjet e thirrësve për çlirim (të gruas), apo ato janë mbuluar nga sëmundja e epshtit?

Jules Simon thotë: "Gruaja që punon jashtë shtëpisë së saj kryen punën e një punëtoreje të thjeshtë, por ajo nuk e kryen punën e një gruaje."³⁰

Një grua e quajtur Kathleen Lind, gruaja e astronautit amerikan Dr. Don Leslie Lind, pra, që nuk ishin familje analfabete, por ishin familje perëndimore në kulmin e arritjes akademike, ka thënë: "Si amvisë, pjesën më të madhe të kohës sime e kaloj në shtëpi. Si grua, besoj se gruaja duhet t'i kushtojë gjithë kohën shtëpisë, burrit dhe fëmijëve të saj.

Më kujtohen ende fjalët e një kleriku, në përgjigje të pyetjes të cilën i parashtroi një grua: "Nëse fati i gruas është shtëpia e saj,

²⁹ "El-Mer'a bejnel-Fikhi uel-Kanun," fq.178.

³⁰ "El-Mer'a bejnel-Fikhi uel-Kanun", fq. 179.

atëherë pse duhet të mësojë ajo? Ai u përgjigj: “Nëse e edukon një burrë, atëherë e ke edukuar një individ. Por, nëse e edukon një grua, atëherë ke edukuar një brez ose një popull.”

Pastaj ajo thotë: “Jam shumë e lumtur që gjithmonë kam qëndruar në shtëpi pranë burrit dhe fëmijëve të mi, madje edhe në ditë të vështira, kur ne kishim nevojë për para. Burri im nuk më kërkoi që të punoja. Filozofia e tij ishte që ne mund t'i sigurojmë nevojat tona bazike, por ne nuk mund t'i rrisim (edukojmë) fëmijët tanë, nëse ‘rripat e frerit’ na rrëshqasin nga duart.”³¹

Vërtet, këto citate janë të qarta dhe nuk kanë nevojë për komentim. Në fakt, ne nuk kemi nevojë për to, pasi ne besojmë se ajo që Allahu e ka zgjedhur për njerëzimin është më e mira (më e dobishmja) dhe kjo është ajo me të cilën ka ardhur feja islame. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”** (*El-Abzab: 36*)

³¹“Risaleh ila ha’ a” (2/61). Marrë nga gazeta: El-Enba El-Ku’ejtijeh.

NJË PYETJE PËR FUND

Pas kësaj vjen një pyetje e fundit, e cila është shumë e rëndësishme: A mund të jetë çdo grua në gjendje ta kryejë këtë detyrë madhështore? A është e mjaftueshme që gruaja thjesht të rrijë në shtëpi për ta përmbushur këtë detyrë?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje themi: Kushti themelor për një grua që të mund ta kryejë këtë detyrë është që ajo të jetë një grua e mirë (devotshme), siç udhëzoi Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem): *“Gruaja martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për prejardhjen e saj, për bukurinë dhe për fenë e saj. Kështu që, zgjidh (fitoje) atë që është fetare, **do të jesh i bekuar!**”*³²

Në këtë hadith, Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ue selem) i sqaroi standardet me të cilat njerëzit e zgjedhin partneren e jetës, pastaj urdhëroi që t’i jepet përparësi standardit të fesë. Disa njerëz si peshore (standard) kanë bukurinë, ndonëse njerëzit dallojnë sa i përket përshkrimin të saj. Të tjerë kanë standard pasurinë apo pozitën shoqërore dhe prejardhjen. Por, standardi që e ka caktuar ligji islam është ai i fesë. Një grua e devotshme është ajo të cilës mund t’i besohet që ta kryejë këtë detyrë madhështore.

Ai që e zgjedh gruan fetare i ka kursyer vetes një përpjekje të madhe, sepse gruaja fetare patjetër duhet të ketë një shkallë të njohurive që e bën atë të kualifikuar për ta kryer punën e saj në mënyrën më të mirë. Ajo e di se çfarë është detyra e saj, është e

³² Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

ndërgjegjshme dhe e vetëdijshme për misionin e saj në jetë. Dhe, me këtë ne kuptojmë se, ajo që nënkuptohet me njohuri këtu, nuk është një certifikatë apo një kualifikim, por njohuri për detyrat që ka obligim t'i kryejë dhe njohuri për mjetet që e ndihmojnë ta bëjë këtë.

Prandaj, është e detyrueshme për gruan që, pasi të mësojë fenë e saj, të mësojë gjithçka që i nevojitet për të kryer detyrat e saj brenda shtëpisë. Ajo duhet të ndjekë çdo gjë të re që shkruhet për temat që i interesojnë, si për shembull temat që kanë të bëjnë me fëmijët, shëndetin apo edukimin e tyre; temat që kanë të bëjnë me shtëpinë dhe mirëmbajtjen e shtëpisë; temat që lidhen me disa çështje sociale; temat që shkruhen për gruan dhe gjëra të tjera që kanë të bëjnë me gratë.

Prania e një gruaje të devotshme, e cila ka dije, është një tregues që kjo grua është e aftë t'i kryejë detyrat e saj. Në anën tjetër, mosdija e gruas dhe mungesa e devotshmërisë, është shkak për dështim, edhe nëse gruaja është e lirë dhe nuk punon. Ajo do të humbasë kohë në vizita boshe, thashetheme dhe ndjekje të modës. Nuk pritet që ky lloj i grave të përmbushë këtë rol të rëndësishëm dhe as të nxjerrë një brez të mirë.

Allahu e di më së miri. Lavdërimet dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin tonë, Muhamed, mbi familjen e shokët e tij!